

- a) Nënshkrimet dhe depozitimin e instrumentave të ratifikimit simbas nenit IV.
 b) Depozitimin e instrumentave t'aderimit simbas nenit V.
 c) Datën në të cilën kjo Konventë do të hyjë në fuqi simbas nenit VI.
 d) Komunikimet dhe njoftimet e marra simbas nenit VII.
 e) Njoftimet e denoncimit të marra simbas dispozitave të paragrafit të parë të nenit VIII.
 f) Mosqënia në fuqi e Konventës në konformitet me paragrafin 2 të nenit VIII.

Neni 11.—

1) Kjo Konventë, tekstet e së cilës në gjuhët engleze, kineze, spanjoll frënge dhe ruse, kanë vlerë të barabartë, do të depozitohet në arshivat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2) Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara do tu dërgojë një kopje të vërtetuar të gjitha shteteve anëtare dhe shteteve jo anëtare të parashkuar në paragrafin e parë të nenit IV.

Për këtë qëllim nënshkruarit, t'autorizuar duhësisht nga Qeveritë respektive, kanë nënshkruar këtë Konventë, e cila u çel për nënshkrim me 17 dhjetorë e një mars një mijë e nëntëqint e pesëdhjet e tre.

D E K R E T

mbi aderimin e Republikës Popullore të Shqipërisë në Konventën për ndalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 9 Dhjetor 1948.

Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë. Mbas pa dhe shqyrtoj Konventën e adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara me 9 Dhjetor 1948 mbi ndalimin dhe ndëshkimin e krimit të Gjenocidit, vendos aderimin e Republikës Popullore të Shqipërisë në këtë Konventë me rezervat që vijojnë.

1) Përsa i përket nenit IX-të, Republika Popullore e Shqipërisë nuk konsiderohet e lidhur nga dispozitat e nenit IX që parashikojnë se mosmarrëveshjet midis Palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, aplikimin ose zbatimin e Konventës do t'i nënshtrohen shqyrtimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, mbi kërkesën e njerës Palë në mosmarrëveshje. Republika Popullore e Shqipërisë deklaroi se përsa i përket kompetencës të Gjykatës mbi mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin, aplikimin dhe zbatimin e Konventës do të vazhdojë të mbrojë pikpamjen, sikundër e ka bërë deri sot, se, në çdo rast të veçantë, akordi i të gjitha palëve në mosmarrëveshje është i nevojshëm për ti dhënë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë kompetencë që të gjykojë dhe vendosë mbi mosmarrëveshjen.

2) Përsa i përket nenit XII. Republika Popullore e Shqipërisë deklaroi se ajo nuk pranon termat e nenit XII-të të Konventës dhe çmon se të gjitha klauzolat e kësaj Konvente duhet t'aplikohen në tokat jo autonome duke përfshirë edhe tokat nën tutori.

Dhe deklaroi se do të sigurojë aplikimin e saj

Tiranë, me 9-11-1954

Nr. i dekretit 1962

PËR PRESIDUMIN E KUVENDIT POPULLOR
 TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË
 SEKRETARI:
 Sami Baholli

KRYETARI:
 Haxhi Lleshi

K O N V E N T A
 PËR NDALIMIN DHE NDESHKIMIN E KRIMIT TË GJENOCIDIT ADOPTUAR
 NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME E KOMBEVE TË BASHKUARA
 ME 9 DHJETOR 1948

Palët kontraktuese;

Duke marrë parasysh se Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me rezolutën e saj 96 (I) datë 11 dhjetor 1946, ka deklaruar se gjenocidi është një krim simbas së drejtës ndërkombëtare në kundërshtim me frymën dhe qëllimet e Kombeve të Bashkuara dhe që bota e qytetëruar e dënon;

Duke ditur se në të gjitha periudhat e historisë gjenocidi i ka shkakuar humbje të mëdha njerëzimit;

Të bindur se, për të çliruar njerëzimin nga një mjerim kaq i tmershëm, bashkëpunimi ndërkombëtar është i nevojshëm;

Ranë në marrëveshje për sa vijon:

Neni 1.—

Palët kontraktuese konfirmojnë se gjenocidi qoftë i kryer në kohë paqe ose në kohë lufte, është një krim simbas së drejtës ndërkombëtare të cilin ato angazhohen t'o ndalojnë dhe ta denojnë.

Neni 2.—

Në këtë Konventë për gjenocid kuptohet një nga veprimet e më poshtëme, i bërë me qëllim për të shkatëruar, plotësisht ose pjesërisht një grup kombëtar, etnik, racial ose fetar, siç është:

- vrasja e antarëve të grupit.
- dëmtimi i rëndë trupor ose mendor i antarëve të grupit.
- vumja qëllimisht e grupit në kondita jetese të tilla që shkaktojnë shkatërimin e tij fizik të plotë ose të pjesëshëm.
- masa që kanë për qëllim të ndalojnë lindjet në gjirin e grupit.
- transferim me forcë i fëmijëve të grupit në një grup tjetër.

Neni 3.—

Dënohen aktet që vijojnë:

- Gjenocidi.
- Marrëveshja për të kryer gjenocidin.
- Nxitja direkte dhe publike për të kryer gjenocidin.
- Tentativa e gjenocidit.
- Komplisiteti në gjenocid.

Neni 4.—

Personat që kanë kryer gjenocidin ose një çfardo nga aktet e tjera të përmendura në nenin III do të dënohen, qofshin këta qeveritarë, funksionarë ose privatë.

Neni 5.—

Palët kontraktuese angazhohen të marrin, në konformitet me kushtetutat e tyre përkatëse, masat ligjore të nevojshme për të siguruar zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente dhe veçanërisht të parashikojnë ndëshkime penale efektive kundër personave fajtor të gjenocidit ose të një nga aktet e përmendura në nenin III.

Neni 6.—

Personat e akuzuar për gjenocid ose cilin do nga aktet e tjera të përmendura në nenin III do të nxiren përpara gjykatave kompetente të Shtetit

në tokën e të cilit është kryer akti ose përpara gjykatës Ndërkombëtare kriminale e cila do të jetë kompetente kundrejt atyre nga Palët kontraktgjyqës që do të kenë njohur juridiksionin e saj.

Neni 7.

Gjenocidi dhe aktet e tjera të përmendura në nenin III nuk konsiderohen si krime politike përsa i përket ekstradimit.

Palët kontraktgjyqës angazhohen në një rast të tillë të lejojnë ekstradimin konform legjisacionit të tyre dhe traktateve në fuqi.

Neni 8.—

Çdo Palë kontraktgjyqës mund t'u drejtohet organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara, me qëllim që këto të marrin, konform Kartës së Kombeve të Bashkuara, masat që do të gjykojnë të përshtatshme për ndalimin dhe ndëshkimin e akteve të gjenocidit ose të njerit prej akteve të përmendura në nenin III-të.

Neni 9.—

Mosmarrëveshjet midis Palëve kontraktgjyqës në lidhje me interpretimin aplikimin ose zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë edhe ato që kanë lidhje me përgjegjësinë e një shteti për çeshtje gjenocidi ose për një nga aktet e përmendura në nenin III, do t'i parashtrihen gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë mbi kërkesën e njerës nga Palët në mosmarrëveshje.

Neni 10.—

Kjo Konventë, tekstet e së cilës në gjuhët Engleze, Kineze, Spanjolle, kanë vlerë të njëjtë, do të mbajë datën 9 dhjetor 1948

Neni 11

Kjo Konventë do të hapet për nënshkrimin deri me 31 dhjetor 1949 për çdo anëtar të Kombeve të Bashkuara dhe për çdo shtet tjetër jo anëtar të cilit Asamblea e Përgjithëshme do t'i ketë dërguar një ftesë për këtë qëllim.

Kjo Konventë do të ratifikohet dhe instrumentat e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithëshem të Kombeve të Bashkuara.

Duke filluar nga 1 Janari 1950 në këtë Konventë mund të aderojë çdo Anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe çdo shtet jo anëtar që do të ketë marrë ftesën e lartpërmendur.

Instrumentat e aderimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithëshem të Kombeve të Bashkuara.

Neni 12.—

Çdo Palë kontraktgjyqës, me anën të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithëshem të Kombeve të Bashkuara, mund në çdo kohë të shtrijë aplikimin e kësaj Konvente në të gjitha teritorët ose në njerën nga teritorët për të cilat ajo drejton marrëdhënjet e jashtëme.

Neni 13.

Prej ditës kur të njëzet instrumentat e parë të ratifikimit ose aderimit do të jenë depozituar Sekretari i Përgjithëshem do të mbajë proces-verbal. Ai do t'ja transmetoj kopjen e këtij proces-verbali të gjitha shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe shteteve jo anëtare që bëhet fjalë në nenin XI.

Kjo Konventë do të hyjë në fuqi të nëntëdhjetën ditë mbas datës të depozitimit të instrumentit të njëzet të ratifikimit ose të aderimit.

Çdo ratifikim ose aderim i bërë mbas kësaj date do të hyjë në fuqi të nëntëdhjetën ditë mbas depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit.

Neni 14.—

Kjo Konventë ka një afat prej 10 vjetësh nga data e hyrjes së saj në fuqi: më pas ajo do të jetë në fuqi për një periudhë 5 vjeçare e kështu me radhë kundrejt Palëve Kontraktgjyqës që nuk do ta kenë denoncuar të paktën gjashtë muaj përpara mbarimit t' afatit. Denoncimi bëhet me anën e një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithëshem të Kombeve Bashkuara.

Neni 15.—

Në qoftë se, në vijim të denoncimeve, numuri i Palëve në këtë marrëveshje ulët në 16, konventa pushon së qeni në fuqi nga data me të cilën bën efekt denoncimi i fundit.

Neni 16.—

Kërkesa për revizionimin e kësaj Konvente mund të formulohet në çdo kohë nga çdo Palë kontraktgjyqës me anën e një njoftimi me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithëshem.

Asamblea e Përgjithëshme do të vendosë mbi masat që eventualisht duhen marrë në lidhje me këtë kërkesë.

Neni 17.—

Sekretari i Përgjithëshem i Kombeve të Bashkuara do t'iu njoftojë të gjithë shteteve Anëtarë të Kombeve të Bashkuara dhe Shteteve jo anëtarë të përmendur në nenin XI.

a) Nënshkrimet, ratifikimet dhe aderimet e bëra në zbatim të nenit XII.

b) Njoftimet e marra në zbatim të nenit XII.

c) Datën në të cilën kjo Konventë do të hyjë në fuqi në zbatim të nenit XIII.

d) Denoncimet e bëra në zbatim të nenit XIV.

e) Abrogimin e Konventës në zbatim të nenit XV.

f) Njoftimet e marra në zbatim të nenit XVI.

Neni 18.—

Originali i kësaj Konvente do të depozitohet n'arshivat e O ganizatës së Kombeve të Bashkuara.

Një kopje e vërtetuar do t' u dërgohet të gjitha Shteteve anëtarë të Kombeve të Bashkuara dhe Shteteve jo anëtarë të përmendur në Nenin XI

Neni 19.—

Kjo Konventë do të rregjistrohet nga Sekretari i Përgjithëshem i Kombeve të Bashkuara në datën e hyrjes së saj në fuqi.

DEKRET

Mbi caktimin e numrit të gjyqtarëve dhe të ndihmës gjyqtarëve të gjykatave të qarqeve

Në bazë të nenit 34 të ligjës Nr. 1284 datë 9-6-1951 mbi organizimin gjyqsor, sikurse është ndryshuar me dekretin Nr. 1778 d. 3-12-1953;

Me propozimin e Qeverisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR

V E N D O S I :

Neni 1.—

Numuri i gjyqtarëve dhe i ndihmës gjyqtarëve të gjykatave të qarqeve caktohet si vijon: